

**Beqir META**

## **Fjala e mbylljes**

Të nderuar pjesëmarrës, referues dhe kolegë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që të bëj mbylljen e punimeve të kësaj konference shkencore jubilarë, e cila i kushtohet kontributit dhe sakrificës sublime të familjes Jashari, si dhe gjithë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çlirimin e saj nga sundimi serb.

Konferenca e trajtoi këtë temë në dy rrafshë shkencore, të cilat ishin të lidhura ngushtë midis tyre dhe plotësonin njëra-tjetrën: me ndriçimin e trashëgimisë patriotike të familjes Jashari, dhe në trajtimin e luftës çlirimtare të UÇK-së në shumë dimensione të saj.

Në rrafshin e parë u mbajtën kumtesa me interes e risi shkencore mbi Jasharajt, si një vatër e kahershme patriotike përgjatë shekullit XX, për kontributin e Jasharajve në luftën çlirimtare të Kosovës 1991-1999; për rolin dhe dimensionin e luftës së Jasharajve në kuadër të rezistencës së UÇK-së, u veçua qëndresa epike e grave të familjes Jashari gjatë vitit 1998. Jehona e epopesë së Jasharajve në opinionin shqiptar e të huaj, u pasqyrua dimensionin historik i familjes Jashari, pasqyrimi i sakrificës së Jasharajve në shtypin shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Në rrafshin tjetër u kumtuuan tema shumë interesante mbi veprimtarinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, qëndrimi i diplomacisë dhe i shtetit shqiptar ndaj rezistencës shqiptare në Kosovë, lufta e Kosovës në kancelaritë ndërkombëtare, procesi i legjitimitetit të saj dhe i ndërhyrjes së NATO-s, ndihma e ushtrisë shqiptare për përgatitjen e UÇK-së; evoluimi i qëndrimit të partive politike në Shqipëri ndaj

rezistencës në Kosovë dhe ndikimi i ngjarjeve të vitit 1998 në veprimtarinë e tyre etj.

Këto kumtesa u karakterizuan nga shumë risi shkencore, qoftë faktologjike, qoftë analitike, të cilat përbëjnë një bazë të mirë për të çuar më tej trajtimin shkencor të rezistencës së shqiptarëve në Kosovë në vitet '90, si dhe të historisë së pashlyeshme të familjes Jashari dhe ndikimit të saj në historinë kombëtare më të re.

Të nderuar kolegë,

Më në fund më lejoni t'ju shpreh falënderimin e tri instituteve tona të historisë për këtë kontribut të paçmuar që ju dhatë në këtë Konferencë dhe të shpreh edhe njëherë nderimin dhe respektin tim të thellë për veprën e pavdekshme të Adem Jasharit e familjes së tij, si dhe të gjithë luftëtarëve të UÇK-së që i ndritën faqen kombit tonë.